

# A Duhet të Jem i *Përsosur*?

**Nga Eshli Starku**  
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

*Kjo histori ndodhi në Aruba.*

Henri hyri me ngadalë në dhomën e Fillores. Këmbët i rëndonin teksa shkoi drejt karriges së tij. Mësuesi i tij, Vëllai Ras, i buzëqeshi. “A je gati të flasim për tempullin?” – pyeti ai.

“Po”, – u përgjigj Henri.

*Pse e thashë këtë?* – mendoi Henri kur u ul. Ai nuk ndihej gati. Aspak.

Klasa e Fillores së Henrit po mësonte këngën “Tempullin Shum’ Dua t’Shoh”\*. Klasës së tij i ishte kërkuar të fliste rreth vajtjes në tempull.

Por Henri ndihej i trishtuar. Ai donte të shkonte në tempull kur të ishte në moshën e duhur, por mendonte se kishte bërë shumë gabime.

Një nga një, shokët e Henrit u ngritën në këmbë. Ata ishin të lumtur dhe të emocionuar ndërsa flisnin për vajtjen në tempull një ditë. Henri u ndje gjithnjë e më keq.

Më pas erdhi koha për të kënduar. Henri këndoi së bashku



*Henri donte të shkonte në tempull, por ndiente se kishte bërë shumë gabime.*

me pjesën tjetër të Fillores: “Do bëhem gati sa jam i ri; K’të detyr’ t’shenjt’ kam tani”.

*Si mund të përgatitem për të shkuar në tempull kur bëj kaq shumë gabime?* – mendoi Henri.

Ai u struk më poshtë në karrigen e tij.

Kur mbaroi kënga, vëllai Ras u përkul drejt tij. “A je në rregull?” – e pyeti Henrin.

Henri e hodhi vështrimin te duart e veta. Pastaj tha me zë të ulët: “Dua të shkoj në tempull, por kam frikë se nuk jam i denjë”. Ai mori frymë thellë.

“Unë nuk shkoj gjithmonë mirë me familjen time. Harroj që t’i bëj punët e mia në shtëpi.

Bëj shumë gabime. Në fakt, a duhet të jem i përsosur?”

Vëllai Ras buzëqeshi butësisht. “Të jesh i denjë për të shkuar në tempull nuk do të thotë se duhet të jesh i përsosur. Mund të jemi të denjë duke i mirëbesuar Jezu Krishtit dhe duke u përpjekur me çiltërsi që të zbatojmë urdhërimet. Të gjithë bëjmë gabime, por mund të pendohemi dhe të jemi të pastër përsëri.”

Henri e drejtoi paksa trupin.

“Jam i sigurt se Ati Qiellor është krenar për ty që po përpiqesh të jesh i mirë”, – tha Vëllai Ras.

Henri mendoi për disa gjëra të mira që i kishte bërë atë javë. Ai gatoi darkën me mamën, ndihmoi motrën e tij për detyrat e shtëpisë dhe e përshëndeti një djalë të ri në shkollë.

Pesha e shqetësimeve të Henrit filloi të pakësohej. Ai e dinte se Fryma e Shenjtë po e ndihmonte që të ndiente paqe.

Kur ishte radha e Henrit për të folur, ai buzëqeshi dhe u ngrit në këmbë. “Dua të vazhdoj të pendohem dhe të bëhem më shumë si Jezu Krishti, në mënyrë që një ditë të mund të hyj në tempull”, – tha ai.

Henri u ndje i lumtur kur u ul. Një ditë, do të ishte në gjendje të bënte besëlidhje të shenjta me Perëndinë brenda në tempull. Dontë të bënte më të mirën për t’u përgatitur. ●



## **MARRJA E NJË REKOMANDIMI TEMPULLI**

Vitin që do të mbushësh 12 vjeç, do të takohesh me peshkopin ose presidentin e degës sate që të marrësh një rekomandim tempulli për të bërë pagëzime në tempull. Ai do të të pyesë nëse ke besim tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Ai gjithashtu do të të pyesë nëse po përpiqesh të bësh më të mirën për t’i zbatuar urdhërimet. Një pyetje që *nuk do ta* dëgjosh është: “A je i përsosur?” Ati Qiellor e di se do të bëjmë gabime. Por Ai dëshiron që ne të përpiqemi fort për t’i zbatuar urdhërimet dhe për të bërë zgjedhje të mira. Dhe për shkak të Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij, ne mund të pendohemi kur mëkatojmë dhe të jemi të pastër përsëri.

